



Duke u mbështetur në nenin 43 të Ligjit për Vetëqeverisje lokale, Nr.03/L-040, nenit 47 të Statutit të Komunës dhe nenit 4 të Rregullores për Punë të Kuvendit dhe Komiteteve të Komunës, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës bën këtë:

### N J O F T I M

Njoftohen të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës së Klinës dhe të interesuarit tjerë, që të marrin pjesë në seancën e **IV-të të rregullt të punës për vitin 2019**.

Seanca mbahet **më 30.04.2019 (e martë)**, në sallën e Kuvendit të Komunës së Klinës dhe fillon **në orën 10:00**.

Lidhur me çështjen e mospjesëmarrjes në seancë, t'i referoheni dispozitës së nenit 39 të LVL-së. Për këtë seancë propozohet ky:

### R E N D I I D I T Ë S:

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar,
3. Pyetje dhe përgjigje,
4. Shqyrtimi i Raportit financiar të Komunës për periudhën janar-mars 2019 (ref. Drejtoria e FEZH)
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft- rregullores për themelimin dhe strukturimin e Asamblesë Komunale të Fëmijëve (ref. Drejtoria e Arsimit),
6. Shqyrtimi dhe miratimi i \propozim-vendimit për transferim të mjeteve (ref. Drejtoria e FEZH),
7. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së Drejtorisë së Urbanizmit për ndërrimin e destinimit të parcelës nr.409/3, Zona kadastrale Klinë, vendi i quajtur "Stupovi",
8. Themelimi i Komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim dhe vlerësim të pronës se paluajtshme të Komunës,
9. Shkarkimi dhe themelimi i Komisionit për shqyrtimin e ankesave për ndarje të bursave për studentë

01Nr. 06-15942 2019  
Më 19.04 2019



Kryesuesi,  
Fadil Gashi